



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 prill 2022
Nr.ref.:RK 1987/22

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI172/21

Parashtrues

Emin Behrami

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të autoritetit publik

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Emin Behrami (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), banor i Vushtrrisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilin vendim të autoriteti publik e konteston.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të autoriteti publik, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 4 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka Nimani me Vendim Nr.GJR.KI172/21 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe me Vendim Nr. K.SH.KI172/21 caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 7 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës u kërkua që ta plotësojë formularin zyrtar me informata si dhe të dorëzoj dokumentacionin përcjellës duke specifikuar aktin që konteston brenda afati pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Megjithatë, Gjykata nuk arriti të marrë përgjigje nga parashtruesi.
8. Më 28 dhjetor 2021, Gjykata kërkoi përsëri nga parashtruesi i kërkesës që të plotësojë kërkesën me informata dhe të dorëzoj dokumentacionin përcjellës dhe vendimet e autoriteteve publike që i konteston brenda afati prej shtatë (7) ditësh.
9. Më 15 shkurt 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës paraqet kërkesë për herë të tretë në Gjykatë.
11. Në lidhje me kërkesën e parë, më 27 prill 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI26/10, nëpërmjet të cilës kontestoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 14/2008, të 10 tetorit 2008, dhe Vendimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 260/2008, të 2 korrikut 2008. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte shkelje të të drejtave të tij kushtetuese në lidhje me dy çështje të ndërlidhura: (1) çështja e të drejtës së pronës lidhur me ngastrën kadastrale dhe shtëpinë e ndërtuar në të; dhe (2) çështja e të drejtës së pronës lidhur me çezmën që gjendet në ngastrën e kontestuar kadastrale. Më 27 shkurt 2010, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri, përmes së cilës refuzoi kërkesën e parashtruesit me arsyetimin se nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç; kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
12. Në lidhjen me kërkesën e dytë, më 29 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën KI90/15, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 39/2015, të 19 marsit 2015, Aktgjykimin e gjykatës së Apelit, Ca. nr.2908/2013, të 22 tetorit 2014 dhe Aktgjykimin e gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2351/10, të 15 shkurtit 2013. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast pretendonte se është shkelur e drejta në punë e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Përveç të drejtës së punës, parashtruesi në këtë rast ankohej edhe për: a) procedurat e zhvilluara nga komisionet disiplinore të BIK-ut; b) procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta, respektivisht në Gjykatën Supreme përkitazi me kompetencën e komisioneve disiplinore dhe të refuzimit të kërkesëpadisë së parashtruesit për kthim në vendin e punës, si dhe kompensimin e të ardhurave personale të humbura; dhe c) mos arsyetimin e Drejtorisë për arsim dhe kulturë për mos vazhdimin e kontratës së punës. Më 14 shtator 2016, Gjykata nxori Aktvendimin për papranueshmëri, ku refuzoi kërkesën si qartazi e pabazuar dhe deklaroi të papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës.

Faktet e rastit lidhje me kërkesën e tanishme KI172/21

13. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte arsimtar në shkollën e mesme islame "Alauddin" në Prishtinë
14. Me 7 shtator 2010, Komisioni disiplinor i shkallës së parë i BIK-ut, me Vendimin nr. 631/10, vendosi që t'ia ndërpres parashtruesit marrëdhënien e punës për shkak të shkeljeve serioze të rregullave të BIK-ut. Parashtruesi u ankua pranë Komisionit Disiplinor të shkallës së dytë të BIK-ut.
15. Me 23 tetor 2010, Komisioni Disiplinor i shkallës së dytë i BIK-ut (Vendimi nr.799/10), vërtetoi Vendimin e Komisionit Disiplinor të shkallës së parë.

16. Me 2 nëntor 2010, parashtruesi paraqiti padi ne Gjykatën Themelore ne Prishtine, kundër Vendimit 631/10 te Komisionit Disiplinor te shkalles se pare dhe Vendimit 799/10 te shkalles se dyte, për shkak te shkeljeve te dispozitave themelore te Kushtetutës se BIK-ut dhe LPK-së
17. Me 15 shkurt 2013, Gjykata Themelore ne Prishtine, me Aktgjykimin C. nr. 2351/10, e refuzoi si te pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, përkitazi me kërkesën e tij për anulimin e vendimeve te komisioneve disiplinore te BIK-ut dhe te kërkesës se tij për kthim ne vendin e punës, si dhe te kompensimit të ardhurave personale dhe të dëmeve të tjera materiale.
18. Me 30 prill 2013, parashtruesi paraqiti ankese ne Gjykatën e Apelit ndaj vendimit te Gjykatës Themelore ne Prishtine për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës kontestimore; vërtetimit te gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike; dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
19. Me 22 tetor 2014, Gjykata e Apelit në Prishtinë, me Aktgjykimin AC.nr. 2908/2013, refuzoi si te pabazuar ankesën e parashtruesit për shkak se qëndrimi juridik i gjykatës se shkalles se pare ka qene i rregullt dhe i bazuar ne ligj, si dhe nuk ka pasur shkelje qenësore te procedurës kontestimore apo aplikim te gabuar te se drejtës materiale.
20. Me 22 tetor 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme te Kosovës.
21. Me 19 mars 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 39/2015, e pranoi kërkesëpadinë e parashtruesit si pjesërisht të bazuar; i anuloi si të kundërligjshme vendimet e komisioneve disiplinore të shkalles se pare dhe të shkalles se dytë; dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit për kthim në vendin e punës dhe për kompensimin e të ardhurave personale mujore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës thekson *“Për rishqyrtimin e padisë sime e regjistruar ne Gjykatën Themelore ne Prishtine me dt.02.11.20 II kundër Vendimit nr. 799/11 o te dt.23.1 0.2010 te Komisionit Disiplinor te Kuvendit te Bashkësisë Islame të Kosovës, i cili e përlligj Vendimin nr.631/1 o te dt.07.09.20 10 te Komisionit Disiplinor te Kryesisë se Bashkësisë Islame të Kosovës.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata në vazhdim i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

[...].

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Në kontekstin e dispozitave të mësipërme, Gjykata thekson se në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 1 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit, palët duhet të kontestojnë një akt të caktuar të autoritetit publik në Gjykatë. Përveç kësaj, në bazë të nenit 48 të Ligjit, përveç deklarimit të aktit specifik të autoritetit publik i cili kontestohet, palët janë të detyruara të deklarojnë qartë se cilat të drejta dhe liri ata pretendojnë se u janë shkelur. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi, pavarësisht kërkesës së Gjykatës për sqarim, (i) nuk qartësoj para Gjykatës aktin e autoritetit publik i cili kontestohet, dhe (ii) nuk plotësoj kërkesën në kuptim të dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm mbështetës duke përfshirë vendimin e autoritetit publik të cilin e konteston.
27. Gjykata rikujton se, më 21 shtator 2021, kishte pranuar një kërkesë nga parashtruesi i kërkesës. Duke qenë se kërkesa nuk ishte e kompletuar dhe nuk përmbante të dhëna të vlefshme, informata/dokumente dhe as vendimin e specifikuar të autoritet publik të cilin e konteston, Gjykata me 7 tetor 2021 kërkoi nga parashtruesi që të plotësoj kërkesën me të dhëna duke si dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshme mbështetës duke përfshirë edhe dorëzimin e vendimit të fundit të cilin pretendon që i konteston.

28. Gjykata po ashtu rikujton se më 28 dhjetor 2021, kërkoi përsëri nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzon dokumentet përcjellëse dhe vendimet e autoriteteve publike që pretendon se i konteston, por parashtruesi nuk arriti të përgjigjet kërkesave të Gjykatës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 35 (5) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën”.

[...]

30. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtruesi është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtruesit me një kërkesë të tillë, por pa sukses.
31. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson se përkundër kërkesave specifike të Gjykatës drejtuar parashtruesit të kërkesës, ky i fundit i) nuk e ka specifikuar aktin e autoritet publik që e konteston; si dhe ii) nuk i kishte dorëzuar të gjitha vendimet që ndërlidhen me rastin e tij.
32. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret kërkesa e parashtruesit është e paqartë në kuptim se cilin akt të autoritetit publik parashtruesi e konteston në Gjykatë; dhe e paplotë në kuptim të mos dorëzimit të dokumentacion të nevojshme mbështetës duke përfshirë vendimin të cilin parashtruesi pretendon që e konteston.
33. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak se është e paplotë dhe e paqartë, siç përcaktohet në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.
34. Gjykata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër (shih rastet e Gjykatës KI165/21 *Parashtrues Hasret Bekteshi*, Vendim për refuzim të kërkesës i 4 nëntorit 2021; KI89/18, *Parashtrues Agim Jashari*, Vendim për refuzim të kërkesës i 27 nëntorit 2018; KI74/18, *Parashtrues Gëzim Murati*, Vendim për refuzim të kërkesës i 3 dhjetorit 2018; KI78/20, KI79/20 dhe KI80/20, *Parashtrues*

Hilmi Aliu dhe të tjerët, Vendim për refuzim të kërkesës i 11 nëntorit 2020; KI90/20 Parashtrues Arben Boletini, Vendim për refuzim të kërkesës i 25 nëntorit 2020).

35. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër në pajtim me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 15 shkurt 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani